



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:164766

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01549781

P.nr.190/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Sabrije Rraci me pjesmarrjen e bashkëpimetorit profesional Zymer Metaj në çështjen penale kundër të pandehurit R. (S.) S. nga fshatiK., për shkak të veprës penale të ‘‘Uzurpim i paligjshëm i pronës së palujtshme’’, nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë,PP/II Nr.1298/2020,të datës. 19.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 13.01.2021 dhe shqyrtimit gjyqësor të dt. 26.01.2021në prani të Prokurorit të Shtetit, Ersan Qavolli, të pandehurit R. S., të dëmtuarit B. Sh., publikisht shpalli aktgjykimin me dt.28.02.2021 ora 10:00 ndërsa e përpiloi me datën 01.03.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: R. S. i lindur me dt..... në fsh. K., tani me banim në fsh. K., nga babai S. dhe nënës Sh., e vajzërisë R., ka të kryer shkollën fillore i martuar baba i 3 femijëve me profesion punëtor i ndërtimtarisë, gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet me nr. personal,, shqiptar ,shtetas i Republikës së Kosovës mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

Qe nga muaji Mars i vitit 2020, e në vazhdimësi në fsh. K., në mënyrë të kundërligjshme, uzurpon pronën e palujtshme të të dëmtuarit B. Sh., në atë mënyrë qe, edhe pse i dëmtuari në bazë të fletës poseduese është pronar i ngastrës 1-130 ZK në vendin e lartëcekur, i pandehuri përkundër këtij fakti uzurpon pronën e të dëmtuarit dhe atë rreth 136 m² ,në të cilën edhe ndërton katin e parë të një stalle të lopëve, e pasi i dëmtuari e vëren objektin duke u ndërtuar, kërkon nga i pandehuri që të ndalon ndërtimin dhe ta liron pronën, mirëpo i pandehuri nuk vepron sipas kërkesës së të dëmtuarit dhe refuzon ta liron pronën.

Me çka ka kryer vepër penale ‘‘Uzurpim i paligjshëm i pronës së palujtshme’’ nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit: 7,8,9,10,17,21,38,40,43,69,70,dhe nenit 366 par.1 lidhur me par.3 të KPRK, si dhe nenit 359,360,361,365,366,450 të KPPRK, i shqipton.

DËNIM ME KUSHT

I.Të pandehurin R. S., me dënim Burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet, në afat prej 1 (një) viti, në qoftë se i pandehuri, gjatë kësaj kohe te verifikimit nuk do të kryej vepër të re penale.

II.OBLIGOHET: I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën në vlerë prej 20 € (njëzetë Euro), në emër të Kompensimit të Viktimave të Krimin 30 (tridhjetë) Euro, gjithsejtë **50 (pesëdhjetë) Euro**, në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

III.UDHEZOHET: Pala e dëmtuar, B. Sh. nga fsh. K., që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregulltë civil.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngritur Aktakuzë: PP/II Nr.1298/2020, të datës 19.11.2020, kundër të pandehurit, R. S., nga fshati K., për shkak të kryerjes së veprës penale ‘‘Uzërpim i paligjshëm i pronës së palujtshme’’ nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, ndëgjimit të të pandehurit, nxjerrjes dhe administrimit të provave, të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

Në shqyrtimin fillestar të datës 27.10.2020, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, si dhe pasi që të pandehurit i është dhënë mundësia për tu deklaruar për fajsinë apo pafajsinë e tij, duke u njoftuar paraprakisht nga gjykata për favorët dhe pasojat e njëres dhe tjetres, i pandehuri E. A. ka deklaruar se nuk e pranon fajsinë në të gjitha pikat e aktakuzës.

Pasi që i pandehuri: R. S., nuk e pranon fajsinë, gjykata e njoftoi për te drejtat nga neni 249 dhe 250, që në afat prej 30 ditësh të paraqet kundërshtim e aktakuzës dhe provave mbështetëse. I njëjti deklaroi se heqë dorë nga kjo e drejtë dhe dëshiron që të caktohet shqyrtimi gjyqësor.

Meqë i pandehuri gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk e pranon fajsinë për veprën penale e cila i ngarkohet, gjykata zbaton procedurën e provave.

Në shqyrtimin gjyqësor, në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pas administrimit të provave në shqyrtimin e gjyqësor, u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë kjo gjendje faktike: Deklarata e të dëmtuarit B. Sh., i cili deklaroi se i akuzuari i ka uzurpuar një pjesë të parcelës 1-136 m², Qertifikata e pronësisë e dt. 15.08.2020 me nr. 11-2664-2020, me të cilën vërtetohet se ngastra e uzurpuar nga i akuzuari është pronë e të dëmtuarit B., fotografit e vendit të ngjarjes dhe ortofotot- me të cilat shihet shtrirja e tokës së të dëmtuarit e cila është uzurpuar nga i akuzuari dhe parashtesa e të dëmtuarit e dt. 17.03.2020, ku ceket se derisa rasti ishte ë ndërmjetësim i akuzuari keqperdori këtë dhe ka vazhduar ndërtimin.

Sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit ai këtu pranoi se ka ndërtuar një pjesë të pronës në parcelën e të dëmtuarit, prandaj edhe pikërisht ky është veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale, për qka edhe në bazë të nenit 365 jam i bindur se gjykata do të merr aktgjykim fajësues.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroj se: Derisa të kryej gjyqi këtë objekt, kërkoj që askush mos ta shfrytëzoi më tutje as ky e as une. Kërkoj nga gjykata që ky rast të mbyllet sa

më shpejt. Unë i kam ofruar mundësinë më të mirë R. që t'ia jap 3000 Euro, që të ka mundësi të ndërton prap në tokën e tij, por nuk ka pranuar.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaron: Se nëse merret vendim në dëm timin, mua më shkatërrohet gjithqka, se kam shpenzuar shumë për atë objekt. Unë kam kërkuar nga ky që nëse don me tërhiq objektin, atëherë paguaje, dhe po e tërhiq, ndërsa ky nuk ka pranuar kurrqysh. Unë prap po kërkoj nga ju gjykata që të më ndihmoni. Mua më vjen keq që kam ndërtuar në tokën e B.

Gjykata pas administrimit të provave të prezantuar në aktakuzë, në shqyrtim gjyqësor i vlerësoj secilën me vëmendje një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, në bazë të nenit 361 të KPPRK-së dhe si rezultat i vlerësimit të tyre vërtetoj këtë gjendje faktike si në vijim:

Faktet e vërtetuara nga gjykata

Gjykata ka gjetur se i pandehuri, në mënyrë të kundërligjshme, uzurpon pronën e palujtshme të të dëmtuarit B. Sh., në fsh. K. në atë mënyrë që, edhe pse i dëmtuari në bazë të fletës poseduese është pronar i ngastrës 1-130 ZK në vendin e lartëcekur, i pandehuri përkundër këtij fakti uzurpon pronën e të dëmtuarit dhe atë rreth 136 m², një stalle të lopëve, e pasi i dëmtuari e vëren objektin duke u ndërtuar, kërkon nga i pandehuri që të ndalon ndërtimin dhe ta liron pronën, mirëpo i pandehuri nuk vepron sipas kërkesës së të dëmtuarit dhe refuzon ta liron pronën. E tërë kjo është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit si dhe nga prova materiale-fleta poseduese e cila është e evidentuar në emër të të Dëmtuarit.

Analiza dhe vlerësimi i provave

1). Vlerësimi i provave materiale

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoj në bazë të Qertifikatës së pronësisë e dt. 15.08.2020 me nr. 11-2664-2020, me të cilën vërtetojmë se ngastra e uzurpuar nga i akuzuari është pronë e të dëmtuarit B., fotografit e vendit të ngjarjes dhe ortofotot- me të cilat shihet shtrirja e tokës së të dëmtuarit e cila është uzurpuar nga i akuzuari dhe parashtrës e të dëmtuarit e dt. 17.03.2020, ku ceket se derisa rasti ishte ë ndërmjetësim i akuzuari keqperdori këtë dhe ka vazhduar ndërtimin.

2. Vlerësimi i provave personale

Në shqyrtimin gjyqësor, me propozimin e Prokurorit të Shtetit sipas aktakuzës, dëgjohej në cilësinë e dëmtuarit:

I dëmtuari B. Sh. i cili ka deklaruar se: Unë e njoh të akuzuarin dhe nuk i kam raportet e këqija me të vetëm për këtë punë nuk po mujm me përfund, për pronën që gjendet afër shtëpisë së të pandehurit në fsh. prona 1-130 YK, pronë të cilën e kam blerë në vitin 2006, ku nuk kishte shtëpi unë e as ky në at vend. Unë i kam rreth 48 hektar në fsh. të gjitha në emrin tim e cila nuk është e ndarë por vetëm një parcelle të cilën jam duke e shfrytëzuar por vetëm pjesën e uzurpuar nga R. nuk mundem ta shfrytëzoj. I dëmtuari ka potencuar se ne kemi pasur termine për pajtim por nuk kemi mundur të merremi vesh.

Një deponimi të tillë, gjykata i falë besimin, me arsyetimin se i njëjti është në harmoni me provat tjera të nxjerra dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, si dhe për faktin se gjatë deklarimit të tij gjykata nuk ka vërejtur ndonjë pretendim tendencioz. Por deklarata e dëmtuarit ishte objektive dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

I pandehuri në mbrojtjen e vetë deklaron: Une e kam ndërtuar objektin në vitin 2018 dhe ndërtimi i tij më ka kushtuar rreth 10. 000 Euro, plotësisht pajtohet se kam gabuar që nuk e kam marrë kadastrën për më bërë përkufizimin e pronës. Ndërtimi i saj nuk është ndërtuar për një natë por ka zgjat 2 muaj. B. Sh. më ka thirr në telefon në vitin 2020 rreth shtatorit dhe me ka thënë se ked y mundësi, ose rrëzo objektin ose ta dergojmë në gjykatë ta rrëzon gjykata. Une i kam thënë as ti as une por do të merremi vesh, dhe i kam thënë a të dalim të takohem të dielën, ky më ka thënë po, kur erdhi e diela nuk doli në takim, i cili tha se jam në Istog. Kam insistuar të takohemi për marrëveshje por kurrsesi nuk ka pranuar dhenjë natë ka pranuar dmth. Reth një muaj e gjsëm ka zgjat kohën e takimit. Kur u takuam nuk pranoi kurrsesi. Pa dijeninë time e ka dërguar lëndën në prokurori, ku aty mi ofruan dy mundësi: 1. Me tërheq objektin dhe dy ky për të mi paguar 1000 Euro, për tërheqjen e objektit. Andaj si përfundim nuk kemi mundur të merrem vesh kurrsesi. Pastaj më ka thirr në telefon dhe me ka thënë se ke ndërtuar prap mur të cilat nuk ka shanc teorike se jan gjëra që duken veq ato në vitin 2018 dhe një pjesë e kam shtuar një vit më vonë në vitin 2019 afërsisht rreth 30 m². Prokurori i shtetit ia prezanton fletën poseduese në të cilën ceket se pronar i pronës është i dëmtuari B. Sh.. I pandehuri e pranon se prona është e tij, i njëjti deklaron se e kam uzurpuar por pa qëllim. Une jam i gatshëm për marrëveshje por nëse nuk dëmtohet une.

Gjykata ia falë besimin mbrojtjes së të akuzuarit pasi që ai vet e ka pranuar se ka ndërtuar një pjesë të pronës në parcelën e të dëmtuarit, prandaj edhe pikërisht ky është veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale. Mirëpo për qudi nuk e ka pranuar fajësinë.

c) Vlerësimi juridik i çështjes

Me të gjitha provat personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të analizuar dhe të vlerësuara nga gjykata si: dëshmia e të dëmtuarit B. Sh., mbrojtja e të pandehurit e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, si dhe qertifikata e pronës në emër të të dëmtuarit, e të cilat prova gjykata i ka vlerësuar një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim se në tërësi është vërtetuar, se i pandehuri kryer veprën penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së palujtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

I pandehuri ka qene i vetëdijshëm për veprimet e tij, të bëra ndaj të dëmtuarit, si dhe në këto veprime është manifestuar dashja si element i fajësisë. Gjykata konsideron se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale: kundërligjshmëria, dashja si formë e fasjesisë, si dhe vetëdija, andaj përfundon se në veprimet e të të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet inkriminuese të kësaj veprë penale të cilat sajojnë figurën e veprës penale.

Duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 262 par.1 të KPPRK-së në të cilat përcaktohet: “gjykata nuk e shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie, apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.”.

Gjatë vlerësimit të provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësor që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për përjashtimin apo zvogëlimin e përgjegjësisë së tij, andaj të njëjtini ka shpallë fajtor për veprën penale të mashtrimit.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për me tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer.

Rrethanë rënduese Gjykata gjeti shkallen e rrezikshmërisë që paraqet kjo veprë penale dhe dënueshmërin e saj, ku për këtë veprë penale parashihet dënim me gjobë ose me

burgim deri në 2 vjet. Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore te nenit 25 par.2, 26 par.2, 297 par .1, 364, dhe 470 të KPRK-së, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË

P.nr.190/2020, të datës: 01.03.2021

Bashkëpunetori profesional
Zymer Metaj

Gj y q t a r j a
Sabrije Rraci

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.